



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti**

**Mbledhja nr. 134/2024**

**Prishtinë, më 21.05.2024, në orën 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10**

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Mimoza Kusari - Lila, Armend Muja, Driton Hyseni dhe Pal Lekaj, anëtarë.

**Munguan:** Ferat Shala, kryetar, Gramos Agusholli, Abelard Tahiri dhe Valentina Bunjaku – Rexhepi, anëtarë.

**E ftuar:** Hajrije Morina, drejtoreshë e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit – ARRU.

**Pjesëmarrës tjerë:** Sami Gashi, Elsa Krasniqi, Drita Dibrani, Bedri Baliu, Sali Hoxha - GP LVV, Aru Vrsevca – asistente GP Multietnik, Ermira Llapashtica – Kuvend, dhe mediat.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

**Mbledhjen e kryesoi Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 14.5.2024;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) për vitin për vitin 2023;**
- 4. Të ndryshme.**

*Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua njëzëri.*

**2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 14.5.2024**

*Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 14.05.2024, u miratua pa vërejtje.*

### **3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) për vitin për vitin 2023**

**Kryesuesja**, theksoi në bazë të nenit 10 Ligjit nr.05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Autoriteti paraqet raport vjetor të punës për vitin paraprak në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më së voni deri më 31 mars të vitit pasues. Ky raport paraqet sukseset dhe sfidat e ARRU-së, institucion që është përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe të furnizuesve të ujit me shumicë në Kosovë. Për ta prezantuar raportin ia kaloi fjalën drejtoreshës së ARRU-së dhe mandej hapim debat.

**Hajrije Morina – drejtoreshë e ARRU-së**, tha se ky raport përmbledh aktivitetet e realizuara të ARRU gjatë vitit 2023 (1 janar 2023 deri 31 dhjetor 2023) - të 4 departamenteve dhe Njesisë së inspektimit. Në shtojcë të raportit, jepen të përmbledhura në formë tabelash apo grafikonesh disa të dhëna që ilustrojnë performancën e ofruesve të shërbimeve të ujit & ujërave të ndotur, tarifat e aplikueshme për vitin kalendarik 2023 dhe raportin financiar të ARRU-së. Përveç obligimit ligjor për hartim dhe dorëzim të Raportit Vjetor të Punës së ARRU-së në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ky raport synon të jetë një burim shtesë informacioni për publikun dhe palët e interesit. ARRU-ja, në kuadër të mandatit të saj ligjor, publikon të gjitha raportet, urdhëresat dhe të dhënat tjera, lidhur me aktivitetet dhe performancën e sektorit në ueb-faqen e saj. Përkundër të gjitha sfidave dhe vështirësive, ARRU-ja falë angazhimit të stafit të saj dhe bashkëpunimit të mirë me KRU-të dhe palët tjera të interesit, ka arritur të realizojë obligimet e saj ligjore dhe të përmbushë synimet e saj strategjike. Përmes këtyre Synimeve Strategjike, ARRU-ja synon të avancojë më tutje cilësinë e shërbimeve të sektorit të ujit në përgjithësi. Raporti i Punës për vitin 2023, përkatësisht kapitulli 5, ku raportohet për aktivitetet e realizuara të ARRU-së, për periudhën raportuese, ndjek logjikën e Synimeve Strategjike, të cilat janë zbërthyer, pastaj në objektiva përkatëse. Krahas raportimit të statusit të aktiviteteve, janë dhënë përshkrime tekstuale të aktiviteteve të realizuara, krahasuar me aktivitetet e planifikuara në Planin e Performancës për vitin 2023. ARRU-ja gjithashtu, ka realizuar takime dhe ka mirëmbajtur komunikimin dhe bashkëpunimin me organizatat dhe rregullatorët e ujit të vendeve të regjionit (Shqipëri, Mali i Zi dhe Maqedoni e Veriut), ka vazhduar bashkëpunimin me Rregullatorët Evropianë për Ujë - WAREG (European Water Regulators), DANUBIS (Danube Utility Benchmarking and Information Sharing) që është platformë komunikimi dhe shkëmbimi e njohurive dhe të dhënave për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Evropën Juglindore, Lindore dhe Qendrore. Në aspektin e organizimit dhe funksionimit të brendshëm, për ARRU, është me rëndësi që stafi të jetë i përgatitur për sfidat e vazhdueshme me të cilat përballet. Është me rëndësi që ARRU-ja si institucion të jetë atraktiv për ekspertët, që të investohet në ngritjen e kapaciteteve të personelit në fushën e rregullativës ujore. Duke qenë se në Kosovë impiantet e para për përpunimin e ujërave të ndotur janë futur në operim tashmë, sfida për ARRU-në do të jetë caktimi i tarifave “të drejta” për ujërat e ndotur dhe përpunimin e tyre. Ajo theksoi se ka mungesë të stafit dhe kjo bëhet edhe me e vështirë, kur një pjesë e stafit janë në pushime të lehonisë. Ajo theksoi, se ka kërkuar mbështetje të institucioneve përkatëse në këtë drejtim sepse mungesa e stafit po paraqet problem serioz dhe po rrezikohet funksionimi i ARRU-së. Ajo tha se ARRU-ja është e obliguar të ndërrojë zyrat për shkak se në objektin ku janë parashihet ndërtim i lartë, njoftoi se i ka dërguar kërkesë me shkrim AKP-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për të siguruar ndonjë objekt të përshtatshëm nga ata, por që nuk ka marrë përgjigje.

**Driton Hyseni**, pyeti rreth rritjes se ankesave të konsumatorëve drejtuar ARRU-së. Ju keni evidentuar se nuk ka trajtim adekuat të ankesave të konsumatorëve nga ana e KRU-ve, kemi një listë të ankesave që janë drejtuar në ARRU, ku numër i tyre është 438 të vitit 2023, që janë 36% më shumë se sa në vitin 2022, apo 61% më shumë se sa në vitin 2021, këto janë ankesa të shkallës së dytë, a mund ta dimë sa është numri i ankesave të shqyrtuara nga KRU-të?

Hyseni pyeti po ashtu, rreth trajtimit të ankesave nga ARRU-ja, sa janë të kënaqur konsumatorët me përgjigjet e ofruara nga ju? Gjithashtu pyeti rreth koordinimit me komunat veriore të vendit për të inkasuar mjete për shpenzimet e ujit dhe pse Shtërpca nuk po arrin të inkuadrohet në sistemin e Bifurkacionit?

**Hajrije Morina**, tha se nuk i kam të dhënat e sakta të ankesave të trajtuara në KRU, kemi informacione se ka shumë ankesa dhe përgjigjet që po marrin konsumatorët nga KRU-të, po bëjnë prapë ankesa tek ARRU-ja, duke qenë të pakënaqur me përgjigjet e KRU-ve, ky është sinjal që besimi i konsumatorëve në ARU është rritë.

Sa i përket komunave veriore, nuk kemi ndonjë bashkëpunim, ne si ARRU kemi ndëshkuar kompaninë e cila vepron pa licencë në pjesën veriore të Mitrovicës, por që ky dënim nuk ka arrit të inkasohet asnjëherë. Sa i përket integritimit të Komunës së Shtërpçës në sistemin e kompanisë rajonale të Bifurkacionit, kjo komunë është deklaruar së dëshiron të inkuadrohet në këtë sistem, por që për shkak të gjendjes jo të mirë të sistemit jo të mirë të komunës së Shtërpçës dhe mungesës se mjeteve financiare për ta rregulluar këtë sistem, kompania Bifurkacioni ka refuzuar inkuadrimitin e saj në sistemin e tyre.

**Armend Muja**, tha se bazuar nga raporti shohim se në vitin 2023, krahasuar me vitin 2022 është rritë prodhimi i ujit për 17%, dhe ju keni cekur në raportin tuaj se kjo ka ndodh për shkak të instalimit të ujëmatësve në ujësjellësin e Prizrenit dhe Pejës. I bie që tashme edhe me evidenca e kemi të qarte se në 10 vitet e fundit, ujësjellësi i Prizrenit dhe Pejës kane manipuluar me shifra të prodhimit të ujit. Kurse sa i përket ujit të faturuar në vitin 2023, krahasuar me vitin 2022 ka një rritje prej 53%, po ashtu, në bazë të dhënave që keni ofruar edhe të arkëtimiti kemi pas rritje prej 10 milionë krahasuar me kohën, prej para se të merrni ju menaxhimin, këto janë procese të lidhura ndërmjet veti. Cilat ishin arsytet e vonesave më instalime të ujëmatësve?

**Hajrije Morina**, tha se ne zhvillojmë takime të rregullta me përfaqësues të KRU-ve me qëllim të rritjes së performancës së tyre. Ajo tha, se një nga faktorët e vonesave në instalime të ujëmatësve mund të jetë që rregullatori i ujit ka aplikuar metodën e publikimit dhe rangimit të performancës të ndërmarrjeve të ujësjellësve dhe këto rangime janë bërë në bazë të dhënave, të cilat ata i kanë ofruar, të dhëna të pasakta me të cilat e kane nxjerrë veten mirë dhe kane marrë donacione nga Qeveria dhe donatorë të tjerë. Arsye tjetër ka mundur me qenë, nxjerrja e këtyre të dhënave nga menaxhmenti, me qëllim që të mbajnë pozitën, duke u thirrur në menaxhim të suksesshëm. Kompania Hidroregjioni Jugor dhe Hidro Drini, diferenca e ujit të prodhuar më atë të raportuar ka qenë shumë e madhe.

**Armend Muja**, tha se në lidhje me stafin në ARRU, kërkesat janë të arsyeshme. Tha se nga 2000 persona të punësuar në ujësjellësit, 5 % e tyre janë gra, do duhej të tentohet të arrihet baraspeshë gjinore të paktën në kompani publike. Ai tha, se në lidhje me objektin e ARRU-së do të zhvillojmë një takim me AKP-së dhe ka objekte të cilat duhet të ofrohen me prioritet për institucionet publike.

**Hajrije Morina**, tha se infrastruktura e ujit ka nevojë për investime të mëdha, nuk duhet të presim deri të shkatërrohet i gjithë sistemi. Kërkoet bashkëpunim ndërinstitucional dhe të merren hapa të përbashkët për përmirësim të gjendjes. Ajo tha, se duhet të jetë një bord i cili menaxhon me 7 KRU-të dhe jo secila KRU të këtë bordin e vet, kjo për arsye edhe të mungesës se ekspertëve të kësaj fushe.

**Pal Lekaj**, tha se angazhimi i juaj nuk ka munguar por nuk keni gjetur përkrahje as nga Qeveria dhe as nga Kuvendi, pa përkrahje nuk mund t'ia dalësh. Pyeti rreth mbulimit të shpenzimeve të ujit për institucionet fetare dhe kategorive të cilat janë të parapare me ligj, kush i mbulon këto shpenzime, a keni bashkëpunim me ndonjë institucion që mbulon këto shpenzime. Sa i përket investimeve kapitale, nuk kemi investime kapitale, të cilat do të ndikonin drejtpërdrejt në rritjen e furnizimit me ujë dhe në ruajtjen e ujit, ku po çalon ky proces. Ai pyeti se pse nuk po ndodhin investime kapitale, kur aq shumë ka nevoje sistemi për këto investime.

**Hajrije Morina**, tha se rastet sociale dhe objektet e kultit fetar, rregullatori i ujit ka propozuar që me ligjin e ri objektet e kultit fetar të faturohen kurse shpenzimet për rastet sociale të mbulohen nga Qeveria. Në lidhje me investimet kapitale, tha se tarifat e ujit janë shumë të ulëta në vendin tonë, duhet të rritet tarifa në mënyre natyrale, paaftësia e menaxhmetit, po pamundëson rritjen e inkasimeve, duhet të rriten masat ndëshkuese dhe të behet ndryshimi i metodologjisë tarifore.

**Pal Lekaj**, pyeti në lidhje me ujërat e zeza, ai tha se gjendja është shumë e rëndë, a keni ndonjë plan rreth investimeve në ujërat e zeza dhe trajtimit të ujërave atmosferike. Ai pyeti edhe për unifikimin në vetëm një bord i cili do të menaxhonte me KRU-të.

**Hajrije Morina**, tha se historikisht investimet në ujërat e zeza kanë qenë me të ulëta se sa në ujërat e pijes, natyrisht sepse uji i pijes është prioritet. Ka zhvillime pozitive në rajonin e Pejës dhe Gjakovës, presim që ndërmarrjet rajonale të vijnë me projekt propozime për vitin 2025 dhe të shohim se ato projekte çfarë ndikimi do të kenë në përmirësimin e shërbimeve të KRU-ve. Në lidhje me trajtimin e ujërave atmosferike, ajo tha se komunat janë përgjegjëse dhe nuk janë në mandatin tonë. Në lidhje me unifikimin e bordit, ajo tha se është menduar të jetë një bord i cili do të ishte me mandat 5 vjeçar dhe i cili do të punonte me orar të plotë, kjo edhe për faktin se kemi mungesë të profesionistëve të fushës dhe nëse koncentrohemi në vetëm një bord, do të ishte më e lehtë funksionimi.

**Kryesuesja**, ajo tha se rritja e arkëtimit, dëshmon se ka vetëdijësim të institucioneve dhe konsumatorëve, në raport me investimet. Investimet në vitin 2023 në shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në Bardhin e Madh, po ashtu, në vitin 2024, janë të parapara 5.5 milion euro për investime kapitale në zgjerim të rrjetit të ujësjellësit.

Në raport përmendet së KRU Hidroamorava ka paraqitur disa parakushte, në mënyrë që të bëjë një integrim me të gjerë të sistemit, intergrimi i sistemit është obligim ligjor, a keni komunikuar ju me Ministrinë e Ekonomisë për këtë çështje, se si mund të shtyhet nga ana e institucioneve një integrim i tillë. Pyeti po ashtu, rreth monitorimit të përmbushjes së kushteve të licencës, ku keni marrë masa, si shkresa zyrtare paralajmëruese dhe shqiptim të dënimeve, cilat kanë qenë problematikat më të shpeshta, të cilat i keni hasur dhe sa kanë pasur efekt në reflektimin që t'i përmbahen kushteve të licencës.

Në lidhje me çështjen e procesit tarifor, në raport keni përmendur se KRU-të ndërrojnë destinimin e mjeteve për investime, në momentin që i bëjnë këto ndryshime, a kërkojnë aprovimin tuaj?

**Hajrije Morina**, tha se në lidhje me integrimin e sistemit të ujësjellësit në rajonin e Gjilanit, ne kemi insistuar që të kemi takime të rregullta me ministrinë e linjës, Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, është mbajtur vetëm një takim por për fat të keq edhe pse jemi dakorduar, këto takime nuk kane vazhduar. Sa i përket ndëshkimeve për mosrespektimin e kushteve të licencës, kryesisht janë aplikuar ndëshkime për raportim të të dhënave të pasakta nga KRU-të. Do të fillojmë me ndëshkime edhe për mosrealizim të investimeve kapitale, për fat të keq kompanitë e ujësjellësve nuk kërkojnë aprovim për ndërrim të destinimit të mjeteve për investime kapitale.

**Kryesuesja**, tha se në lidhje me raportimin e të dhënave të pasakta nga KRU-të, duhet të behën hetime nga institucionet përgjegjëse dhe të shihet nëse ka elemente të veprave penale.

**Hajrije Morina**, tha se humbjet e ujit janë të mëdha dhe kërkohen investime në sistemin e ujësjellësit, po ashtu, vendosja e mekanizmave për verifikim të raportimit të të dhënave dhe të shohim se a janë të dhëna të sakta këto raportime që behën nga KRU-të.

*Pas debatit, kryesuesja konstatoi, se presim raportet me rekomandime të Komisionit për Buxhet dhe Komisionit për Financa Publike, mandej e procedojmë në seance rezolutën siç parashihet me ligj dhe rregullore.*

#### **4. Të ndryshme**

**Kryesuesja**, njoftoj, së me datë 3.6.2024 (e hënë), është kërkuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë - SKE, që të paraqitet Raporti vjetor implementues për vitin 2023, nga z. Artur Lorkowski, drejtor i SKE-së, është propozuar nga ora 9:30 – 13:30. Propozoj orën 10:00 në parim, mirëpo, nëse ka propozime tjera mund ta lëvizim. Ndërkaq lidhur më mbledhjen e radhës, njoftoi se do ta shqyrtojmë Raportin vjetor të ZRRE-së për vitin 2023.

**Mbledhja përfundoi në orën 12:30.**

**E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.**

**Jeta Statovci,  
Zëvendëskryetare e parë e Komisionit**